Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian

PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Project Ahead
Società cooperativa

EMBRACE

Modele Sipërmarrjeje që Ndërtojnë Marrëdhënie dhe Ekonomi Krijuese

EMBRACE është një iniciativë e zbatuar në Shqipëri për mbështetjen e Sipërmarrjeve Sociale ekzistuese dhe të reja për të përshtatur më mirë produktet dhe shërbimet e tyre dhe për t'u pozicionuar në treg brenda kuadrit ligjor dhe regullator.

Projekti "EMBRACE – Modele Sipërmarrjeje që ndërtojnë Marrëdhënie dhe Ekonomi Krijuese" zbatohet nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim në partneritet me organizatën Project Ahead (Itali), dhe financohet nga Bashkimi Evropian nëpërmjet Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri.

Programi i Ndërtimit të Kapaciteteve

#3 Thirrje të Hapura për Shprehje Interesi

për Organizatat e Shoqërisë Civile për të marrë pjesë në programin e ndërtimit të kapaciteteve.

63 pjesëmarrës nga **47 OJF** kanë qenë pjesë e programit të ndërtimit të kapaciteteve mbi ***"Modelin e gjenerimit të të ardhurave për OJF-të nga shërbimet me pagesë, produktet dhe asetet".***

Mbulimi Gjeografik



Shpërndarja Gjinore

75%

25%

Sesione Trajnimi dhe Mentorimi

180 ditë *asistencë teknike për* **47 OJF** *për të:*

- Vlerësuar pikat e forta dhe të dobëta organizative në lidhje me shërbimet/produktet.
- Analizuar anët e forta dhe të dobëta të modeleve të ndryshme të biznesit.
- Zhvilluar një analizë konkurrentësh të shkallës së parë dhe të dytë.
- Diskutuar mbi modelin e biznesit në lidhje me misionin e organizatës.
- Përcaktuar vlerën e propozuar, avantazhin konkurrues, grupet e synuara dhe çmimin e shërbimeve/produkteve.
- Zhvilluar një plan biznesi.
- Krijuar një strategji marketingu.
  (identifikimi i kanale promovuese/marketing; kostot, etj)
- Zhvilluar aftësitë dhe teknikat për prezantimin e shërbimeve/produkteve.
- Qëndruar në krye të dinamikës së tregut për të zbatuar modelin e biznesit.





Skema e Financimit për Sipërmarrjet Sociale

#3 Thirrje të Hapura për Projekt Propozime

për të mbështetur promovimin e iniciativave ekzistuese të sipërmarrjeve sociale dhe zhvillimin e atyre të reja në të gjithë vendin.

101,000 EUR buxheti total i mbështetjes

15 nisma të sipërmarrjeve sociale janë mbështetur

11 nga 15 SS-të e mbështetura

kanë qënë pjesë e programit të ndërtimit të kapaciteteve

SIPËRMARRJET SOCIALE TË MBËSHTETURA PËRMES SKEMËS SË FINANCIMIT

ARKA E RINISË
CODE PARTNERS
SHKODËR

ARTIZANËT NË WEB
TID KRUJA
KRUJË

FERMA EKO-SOCIALE
THE DOOR
SHKODËR

EDUKIM PËR TË GJITHË (E4ALL)
RRJETI PËR DEMOKRACI I GRAVE, SHQIPËRI
TIRANË

QENDRA MAMICARE
FONDACIONI SPITALOR I NËNËS DHE FËMIJËS
TIRANË

HORIZONTE TË REJA PËR GRATË E DISAVANTAZHUARA
QENDRA SOCIALE NË NDIHMË TË NJERËZVE NË NEVOJË
FUSHË-ARRËZ

APP - TOUR
VJOSA EXPLORER
PËRMET

TIRANA TRAILS APP
TIRANA EKSPRES
TIRANË

TE XHONI CAFE
JONATHAN CENTER
TIRANË

TEZGJAHU, TRADITË DHE PUNËSIM PËR GRATË E VAJZAT NË NEVOJË
VIZION OJF
PESHKOPI

RICIKLIMI I MBETJEVE SI NJË ALTERNATIVË PËR PUNËSIMIN E GRAVE
ZEJTARËT E VERIUT
SHKODËR

SFIDA VAZHDON - DRITA CLEANING
VOICE OF ROMA
FIER

MADE IN PRISON
ORGANIZATA ORKIDEA TIRANË

PREJ DURËVE T'NATYRËS
WOMEN CENTER "HAPA TË LEHTË"
SHKODËR

CODES OF SHKODRA LAKE
WELL POINT
SHKODËR

për më shumë klikoni këtu

FUSHAT E SHËRBIMEVE DHE PRODUKTEVE

- Produkte artizanale në tezgjah.
- Produkte artizanale të krijuara nga riciklimi i shelgjeve.
- Promovimi dhe shitja e produkteve artizanale përmes platformave web.
- Grumbullimi, përpunimi dhe promovimi i produkteve bio.
- Promovimi i turizmit në natyrë në qytetin e Tiranës dhe Përmetit përmes aplikacioneve celulare.
- Shërbime edukuese për fëmijët, të rinjtë, prindërit dhe një komuniteti të gjerë të grupeve të marginalizuara.

ARRITJET KRYESORE

- Integrimi i gruas në fuqinë punëtore.
- Krijimi i vendeve të punës për personat me aftësi të kufizuar dhe integrimi i tyre.
- Krijimi i vendeve të punës dhe kohezionit social për të rinjtë.
- Përfshirje sociale e grupeve të marginalizuara.

Ndërtim Kapacitetesh dhe Rrjetëzim Ndërkombëtar për Sipërmarrjet Sociale



12 ditë *trajnimi mbi:*

- Eko-sistemin e sipërmarrjeve sociale dhe ekonominë sociale.
- Rrjetëzimin dhe ndërtimin e partneriteteve me sektorin e biznesit.
- Zhvillimin organizativ dhe qendrueshmerinë e sipërmarrjes sociale.
- Menaxhimin financiar dhe raportimin tek palët e treta.
- Mjetet dhe rregullat mbi vizibilitetin dhe komunikimin.









15 Sipërmarrje Sociale

- U informuan mbi mundësitë e financimit në mbështetje të veprimtarisë së tyre.
- U prezantuan me 16 rrjete Evropiane dhe rajonale që punojnë/mbështesin sipërmarrjet sociale.
- Morrën pjesë në sesione online shkëmbimi eksperiencash me ekspertë italian mbi bizneset e tyre.
- U njohën më një rrjet të gjerë të sipërmarrjeve sociale në Itali.



Prezantimi i Modeleve të Sipërmarrjeve dhe Rrjetëzim (Eventet OJF-Biznese)

30 iniciativa të sipërmarrjeve sociale u prezantuan gjatë 2 evente.

29 biznese (sektori financiar, telekomunikacioni, turizmi dhe korporata të tjera) eksploruan mundësi partneriteti me SS-të mbi shkëmbimin e produkteve/shërbimeve dhe mbështetjen nëpërmjet Përgjegjësisë Sociale të Biznesit.

10 biznese ofruan asistencë pro-bono mbi marketimin e produkteve, zhvillimin e kontratave të biznesit dhe raportimin tek autoritetet shtetërore.

Eventi Rrathë Dhurues

“Rrathë Dhurues” është një event për ngritjen e fondeve live, i cili i jep mundësinë individëve nga fusha të ndryshme për tu bërë bashkë më një qëllim filantropik për të mbështetur projekte/kauza për të cilat ata shfaqin interes. Qëllimi kryesor i këtij eventi është sigurimi i mbështetjes financiare nga biznese, individë, apo donatorë të tjerë, për aktivitetet e OJF-ve duke synuar një transformim pozitiv dhe të qëndrueshëm për individë, komunitete specifike dhe shoqërinë në tërësi.

Eventi mblodhi së bashku përfaqësues të lartë të sektorit të biznesit, komunitetit të donatorëve, institucioneve diplomatike, shoqërisë civile, medias, artit etj., të cilët ofruan mbështetje financiare dhe materiale për tre iniciativa të cilat do të transformojnë jetën dhe do të sjellin ndryshime të qendrueshme sociale për komunitete në nevojë.

1,885,874 Lekë shuma e grumbulluar gjatë eventit

3 ide të mbështetura

Një kopsht për fëmijët e fshatit Blliçe, Dibër

Vizion OJF

Adopto një terapi! - Mbështetje për fëmijët me aftësi të kufizuara intelektuale

Down Syndrome Albania

Edukimi dhe integrimi i fëmijëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian përmes sportit

Shoqata për të Drejtat e Komunitetit Rom dhe Egjiptian, Shkodër

më shumë mbi idetë



Zhvillimi i një Mjedisi të Favorshëm për Sipërmarrjet Sociale në Shqipëri

Debate Publike kombëtare dhe ndërkombëtare mes sipërmarrësve social, investitorëve, bizneseve dhe aktorëve shtetëror.

Aksione advokasie të hartuara bashkarisht me sipërmarrësit social.

Deklaratë e Ndërmarrjeve Sociale në vend dhe Organizatave Mbështetëse

Deklaratë Publike drejtuar aktorëve shtetërorë me një seri rekomandimesh në lidhje me kuadrin ligjor për sipërmarrjet sociale.

Krijuan bazën drejt një kuadri ligjor të favorshëm për zhvillimin e mëtejshëm të sipërmarrjeve sociale në Shqipëri.

Kërkime dhe Studime

DËSHMI

Vjosa Explorer

“Programet e trajnimit dhe asistencës për të realizuar një analizë SWOT mbi shërbimet, burimet njerëzore, etj, na ndihmuan të orientohemi drejt një modeli të qendrueshëm biznesi për ofrimin e shërbimeve tona (paketave turistike etj), për përballimin më të mirë të konkurencës në rritje, dhe gjenerimin e të ardhurave për qendrueshmërinë e organizatës.
Kemi rritur bashkëpunimin me shumë aktorë dhe ekspozimin ndaj komunitetit donator për sigurimin e vazhdimësisë së aktiviteteve tona. Mundësi shumë Të mira ekspozimi në evente të ndryshme."

Rrjeti për Demokraci i Grave, Shqipëri

“Programi i trajnimeve na ndihmoi të zhvillojmë një plan biznesi në lidhje me shërbimet që po ofrojmë dhe një plan marketingu për promovimin e tyre. Gjithashtu na orientoi për të qenë të suksesshëm në planifikimin, hartimin dhe zbatimin e iniciativës tonë sipërmarrëse.
Rritje të njohurive mbi veprimtarinë mbështetëse që kanë biznezet, kontakte me subjekte që mund të na mbështesin në të ardhmen."

Voice of Roma

“Ky program trajnimi më ka ndihmuar të kuptoj më shumë mbi zhvillimin e një sipërmarrjeje sociale dhe modelin e biznesit për shërbimet e ofruara. Marrja e asistencës për realizimin e një analize konkurrentësh në lidhje me shërbimin e pastrimit të ofruar në qytetin e Fierit, më ndihmoi ta kapërcej këtë hendek."

TID Kruja

“Përmes sesioneve të mentorimit nga ekspertë vendas dhe të huaj, arritëm të identifikojmë “qoshkën e tregut” (niche) që do të sillnim përmes kësaj iniciative sipërmarrëse në tregun shqiptar, por jo vetëm. Përgatitja e planit të biznesit, sugjerimi i ideve të reja për marketing të produkteve të ofruara nga shoqata TID Kruja mbeten vlerë e shtuar për ngritjen dhe zbatimin e iniciativës sonë sipërmarrëse.
Përfituam asistencë për vendosjen e kontakteve dhe krijimin e marrëdhënieve me tre banka të nivelit të dytë për vazhdimësinë e aktivitetit ekonomik."

Zejtarët e Veriut

"Kemi mësuar mbi procedurat e raportimit financiar tek palët e treta dhe zhvillimin e një plani të qendrueshëm biznesi. Analiza kosto-përfitim e produkteve, ka rritur kapacitetin prodhues dhe të ardhurat gjithashtu. Asistenca për marketingun e produkteve ka ndikuar në zgjerimin e rrjetit të klienteve, rritjen e shitjeve dhe gjenerimin e të ardhurave."

Jonathan Center

"Programi i asistencës na ka ndihmuar shumë për vleresimin e biznesit, dhe finalizimin e një plani biznesi për shërbimet tona. Rekomandimet për ndryshime në ofrimin e shërbimeve dhe rivlerësimin e çmimeve të produkteve kanë rritur punën dhe të ardhurat nga shërbimet. Përmirësuam vizibilitetin tonë duke rritur ndjeshëm numrin e ndjekësve në rrjete sociale, media etj, dhe për rrjedhojë interesin ndaj shërbimeve. Ndërtuam marrëdhënie biznesi me korporata të cilat marrin disa shërbime nga ne."

Qendra Sociale në Ndihmë të Njerëzve në Nevojë

"Kemi mësuar shumë rreth manaxhimit të sipërmarrjes sociale, marketingut, dhe shitjes së produkteve. Një nga aspektet më të rëndësishme ka qenë vendosja në kontakt direkt me biznese dhe korporata të rëndësishme në vend duke ndikuar në gjenerimin e të ardhurave. Krijimi i kësaj sipërmarrje sociale ka qenë suksesi më i madh në 6 vite aktivitet të qendrës sonë duke ndikuar edhe në qendrushmërinë e organizatës për vitet e ardhshme."

Tirana Ekspres

"Projekti ka ndikuar në vizibilitetin e organizatës duke mundësuar partneritete shumë të rëndësishme me aktorë të ngjashëm dhe shumë të suksesshëm në rajon."

Fondacioni Spitalor i Nënës dhe Fëmijës

"Eventi OJF- Biznes ishte një aktivitet jo vetëm interesant por edhe shumë produktiv. Për ne si sipërmarrje ishte shumë e rëndësishme në vendosjen e kontakteve të reja me potencial partneriteti për qendrën por jo vetëm. Praktikisht kemi pasur mundësi të ndërtojmë një marrëdhënie me potencial investimi në të ardhmen me disa korporata të rëndësishme në vend."

Vizion OJF

"Nga eventi OJF-Biznes kemi ndërtuar kontakte dhe bashkëpunime me disa banka të nivelit të dytë dhe korporata të tjera në vend të cilat kanë shfaqur interes mbi produktet tona."

PARTNERSALBANIA
FOR CHANGE AND DEVELOPMENT
Rruga e Elbasanit, N. Park Gate, H. 3 Ap. 71/73, Kutia
Postare 2418/1, 1022, Tiranë, Shqipëri